

Mbizotërimi në Afganistan, Përmirësimi i Aftësive, Forcimi i Bashkëpunimit

Takimi i Rigës që u mbajt më 28 dhe 29 nëntor 2006 ishte një ngjarje e rëndësishme për NATO-n. Kryetarë shtetesh dhe qeverish nga 26 vende anëtare të NATO-s u mbledhën për herë të tetë, që nga fundi i Luftës së Ftohtë, në kryeqytetin e njërit prej vendeve anëtare më të reja të NATO-s. Ashtu siç tha edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer, “asgjë nuk mund ta tregojë më qartë se si Europa ka ndryshuar për më mirë se sa fakti që ky Takim po zhvillohet këtu në Lituani, që është një vend demokratik dhe i lirë”.

Në kryeqytetin e Lituanisë, udhëheqësit e vendeve aleate përforcuan zotimin e tyre ndaj misionit të NATO-s në Afganistan dhe bënë thirrje për një angazhim më të gjerë ndërkombëtar. Ata morën masa për përmirësimin e mëtejshëm të aftësive ushtarake të NATO-s dhe miratuan nisma për të thelluar dhe zgjeruar marrëdhëniet me partnerët. Në këtë mënyrë, Aleanca tregoi aftësinë e saj për t’iu përshtatur përballimit të sfidave të shekullit të 21-të.

Në Rigë, udhëheqësit e vendeve të NATO-s miratuan një Direktivë Politike Gjithëpërfshirëse, një dokument i rëndësishëm politik, që përcakton përparësitë e të gjitha problemeve të aftësive të Aleancës, të disiplinave të planëzimit dhe të zbulimit për dhjetë vitet e ardhshme dhe më tej. Direktiva, që mbështet Konceptin Strategjik të vitit 1999, vlerëson se në një të ardhme të afërt, kërcënimet kryesore ndaj Aleancës janë terrorizmi ndërkombëtar, përhapja e armëve të dëmtimit në masë dhe sistemet e tyre të shpërndarjes, si dhe paqëndrueshmëria e shkaktuar nga shtetet e shpërbëra apo në shpërbërje e sipër, nga krizat rajonale, keqpërdorimi i teknologjive të reja dhe ndërprerja e rrjedhës së burimeve jetësore.

Përkundër këtij sfondi, Direktiva përcakton llojet e operacioneve që Aleanca duhet të jetë në gjendje të kryejë, si dhe llojet e aftësive që do të nevojiten: forcat e NATO-s duhet të jenë të baraspeshuara, elastike dhe të zhdërvjellëta, të afta për të kryer një varg të tërë misionesh, që nga ata me intensitet të ulët deri tek ata më të lartë. Direktiva gjithashtu nënvizon faktin se ka shumë të ngjarë që NATO-s do t'i duhet të kryejë një numër më të madh veprimesh luftarake dhe deri në nivelet më të vogla.

Në kohën e Takimit të Rigës Aleanca ishte e përfshirë në gjashtë misione dhe operacione në tre kontinente: Forca Ndihmëse e Sigurisë Ndërkombëtare në Afganistan; Forca e Kosovës (KFOR); Operacioni Përpjekja e Fuqishme në Mesdhe; Shtabi i NATO-s në Sarajevë; Misioni Stërvitor i NATO-s në Irak dhe mbështetja e Misionit të Bashkimit Afrikan në Sudan. Gjatë mbledhjes së tyre, udhëheqësit e vendeve aleate i bënë nderime ushtarëve që kanë shërbyer në këto misione dhe më shumë se 50 000 burrave dhe grave të përfshirë në atë kohë. Ata gjithashtu mbajtën një minutë heshtje në shenjë nderimi ndaj të plagosurve dhe të rënëve.

> Angazhimi i vazhdueshëm në Afganistan dhe Kosovë

Takimi i Rigës filloi me një darkë pune, më 28 nëntor, që iu kushtua përgjithësisht përparësive kryesore të NATO-s: kontributin për paqe dhe qëndrueshmërinë në Afganistan. Udhëheqësit e vendeve aleate ripohuan solidaritetin e tyre dhe angazhimin afatgjatë ndaj këtij synimi dhe ranë në ujdj për heqjen e kufizimeve kombëtare mbi modalitetet e përdorimit të forcave për të rritur më lart efektshmërinë e Forcës Ndihmëse të Sigurisë Ndërkombëtare të drejtuar nga NATO. Udhëheqësit e vendeve të NATO-s gjithashtu përsëritën faktin se, pavarësisht nga kufizimet që mbeten, në një gjendje emergjence çdo aleat do të marrë pjesë në ndihmë të forcave që kërkojnë mbështetje. Një numër vendesh gjithashtu premtuan mjete plotësuese, duke përfshirë aeroplanë luftarakë, helikopterë, kompani këmbësorie dhe ekupe stërvitore për të mbështetur Ushtrinë Kombëtare Afgane.

Duke njohur rëndësinë e rindërtimit dhe të zhvillimit të qëndrueshmërisë afatgjatë të Afganistanit, udhëheqësit e vendeve të NATO-s bënë thirrje për një angazhim më të gjerë ndërkombëtar dhe një këndvështrim gjithëpërmbledhës, duke përfshirë aspektet politike, ushtarake dhe ekonomike. “Nuk mund të ketë siguri në Afganistan pa zhvillim dhe nuk mund të ketë zhvillim pa siguri”, theksuan ata në deklaratën e Takimit. Udhëheqësit e vendeve të NATO-s mirëpritën propozimet për një Grup Kontakti, që do të afronte aksionarë kryesorë për të biseduar së bashku dhe për të rënë në ujdj mbi çështje të rëndësishme strategjike. Sekretari i Përgjithshëm u ngarkua për ta zhvilluar më tej këtë propozim.

Udhëheqësit e vendeve aleate gjithashtu diskutuan për Forcën e Kosovës të drejtuar nga NATO (KFOR) dhe pohuan gatishmërinë e Aleancës për të luajtur rolin e saj në plotësimin e dispozitave të sigurisë të një marrëveshjeje mbi statusin e Kosovës. Udhëheqësit e vendeve të NATO-s e bënë të qartë se, ashtu si në Afganistan, suksesi në Kosovë do të varet nga një përpjekje e përqendruar. Në përputhje me këtë, veprimtaria e NATO-s për të siguruar një mjedis të sigurt do të vazhdojë të bashkërendohet me veprimtaritë e Kombeve të Bashkuara, të Bashkimit Europian dhe të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë, me qëllim që të ngrihen institucionet e qeverisjes dhe të mbështeten reformat.

> Një Forcë Kundërvepruese e NATO-s plotësisht operative

Udhëheqësit e vendeve aleate shpallën në Rīgë se Forca Kundërvepruese e NATO-s (FKN) ka arritur aftësinë e plotë operative. Forca teknologjikisht e përparuar përfshin përbërës të forcave ajrore, tokësore, detare dhe speciale, të cilat Aleanca mund t'i përhapë me shpejtësi kudo që të nevojiten. Ajo është në gjendje të kryejë misione në çdo vend të botës në gjithë spektrin e veprimeve, duke përfshirë shpërnguljet, administrimin e fatkeqësive, kundërterrorizmin dhe duke vepruar si një forcë e përparuar fillestare për forcat kryesore më të mëdha. Ajo numëron deri në 25 000 trupa, mund të fillojë rigrupimin pesë ditë pas njoftimit dhe të ruajë aftësinë e veprimeve luftarake për 30 ditë, ose edhe më gjatë nëse rifurnizohet.

Sekretari i Përgjithshëm e karakterizoi aftësinë e plotë operative të FKN-së si “një arritje të madhe, pasi i jep bashkësisë Euro-Atlantike aftësi të pakrahasueshme”. Udhëheqësit e vendeve të NATO-s ranë në ujdi në Rīgë

për financimin e përbashkët të rigrupimeve të FKN-së në rastet e njoftimeve afatshkurtra, një marrëveshje që duhet të shërbejë si një shtysë për vendet që do të marrin pjesë në rrethqarkullimet e ardhshme të forcës.

Marrëveshja veçanërisht mbulon transportimin ajror, “pjesa më e kushtueshme”, sipas Sekretarit të Përgjithshëm. Në aeroportin e Rigës ishte ekspozuar një Boing C-17 gjatë punimeve të Takimit. Katërmbëdhjetë vende anëtare të NATO-s edhe Suedia synojnë të blejnë dhe të përdorin bashkërisht tre ose katër C-17 në kuadrin e Aftësisë së Transportimit Ajror Strategjik të NATO-s, që do të përplotësojë Zgjidhjen e Përkohshme të Transportimit Ajror Strategjik, tashmë në veprim me përdorimin e transportuesve ajrorë rusë dhe ukrainas *Antonov An-124*. Një nismë tjetër është bashkërendimi i mbështetjes për transportuesit ajrorë të së ardhmes A400M.

Forca Kundërvepruese e NATO-s dhe forca të tjera të grupuara nga Aleanca do të mbrohen në të ardhmen nga sistemi i Mbrojtjes Aktive Shtresore Kundërraketë të Teatrit të Luftimeve. Kontrata e integritit dhe teknikës në nivelin e sistemeve, me vlerë 75 milionë euro, u nënshkrua në Rigë nga NATO dhe Korporata Ndërkombëtare e Zbatimeve Shkencore (KNZSH), kryesuese e ekipit industrial që po punon mbi këtë program. Kjo do të sigurojë mbrojtjen kundërraketë të teatrit të luftimeve të NATO-s deri në aftësinë fillestare operative më 2010.

Në Rigë, udhëheqësit e vendeve të NATO-s i dhanë jetë një nisme për transformimin e forcave të operacioneve të posaçme, me synimin për rritjen e nivelit të përgatitjes së përbashkët dhe zhvillimin e doktrinës, përmirësimin e pajisjeve dhe forcimin e ndërveprimit. Aleatët gjithashtu dhanë orientime për punën e mëtejshme në një varg fushash, që janë jetësore për operacionet bashkëkohore, duke përfshirë vrojtimin ajër-

tokë, logjistikën dhe shkëmbimin e të dhënave të zbulimit. Këto dhe një varg i tërë veprimtarish të tjera, që tregojnë shndërrimin e NATO-s në zhvillim e sipër, u shfaqën në Ekspozitën e Transformimit gjatë Takimit.

Transformimi kushton para. Deklarata e Takimit të Rigës theksoi zotimin e aleatëve për vazhdimësinë e sigurimit, veçmas dhe bashkërisht, të burimeve të nevojshme, që i mundësojnë NATO-s të kryejë detyrat që kërkojnë prej saj. Për këtë arsye ata i bënë thirrje shteteve anëtare me shpenzime të ulëta për mbrojtje që t'i rrisin këto shpenzime konkretisht.

> Mirëpritja e partnerëve të rinj

Në Rigë, udhëheqësit e vendeve të NATO-s ranë në ujdë që të ftojnë edhe tre vende të tjera që të bashkohen në Partneritetin për Paqe dhe në Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik: Bosnjën e Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë. Sekretari i Përgjithshëm tha se anëtarësia në Partneritetin për Paqe do të ndihmonte që t'i sillte këto vende “më plotësisht në familjen Euro-Atlantike” dhe, ndërkohë, nënvizoi urgjencën e vazhdueshme për një bashkëpunim të plotë me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

Udhëheqësit e vendeve të NATO-s dhanë atë që Sekretari i Përgjithshëm e quajti një “sinjal të qartë” ndaj vendeve të përfshira në Planin e Veprimit për Anëtarësim, si Shqipëria, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, se “Aleanca synon t'i zgjerojë më tej ftesat për ato vende që përmbushin standardet bazë të NATO-s dhe që janë në gjendje për të kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin Euro-Atlantik” në Takimin e ardhshëm të NATO-s më 2008.

Një drejtim i punës së udhëheqësve të vendeve aleate në Rīgë ishte zhvillimi i plotë i potencialit politik dhe praktik të strukturave të partneritetit të NATO-s dhe të marrëdhënieve të saj me Vendet e Kontaktit, si Australia, Zelanda e Re dhe Japonia. Kjo do të përfshijë masa për t'i bërë këshillimet edhe më të përqendruara, për të pasur forma mbledhjeje më elastike, dhe për të mundësuar shfrytëzimin më gjerësisht të instrumenteve të njohura të partneritetit për partnerët e rinj, si të atyre në procesin e Dialogut Mesdhetar, në Nismën e Bashkëpunimit të Stambollit, si dhe të Vendeve të Kontaktit.

Në Rīgë, udhëheqësit e vendeve aleate ndërmorën Nismën e Bashkëpunimit të Praktikës Stërvitore të NATO-s për të ndihmuar në përgatitjen e forcave ushtarake të partnerëve të vet të Dialogut Mesdhetar dhe të Nismës së Bashkëpunimit të Stambollit. Kjo do të bëhet përmes një plani me faza, së pari, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në programet ekzistuese të edukimit e të stërvitjes së NATO-s dhe në instrumentet e partneritetit, si dhe nëpërmjet ngritjes së një fakulteti të Lindjes së Mesme në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Romë. Në një fazë të dytë, NATO mund të mbështesë ngritjen e një strukture të veçantë përgatitjeje në Lindjen e Mesme.

Së fundi, Riga gjithashtu ishte një mundësi për udhëheqësit e vendeve aleate për të mirëpritur nisjen e një Dialogu Intensiv me Gjeorgjinë mbi çështjet lidhur me aspiratat e saj për anëtarësim. Ata gjithashtu ripohuan rëndësinë e Partneritetit të Dallueshëm NATO-Ukrainë dhe mirëpritën përparimin e bërë në kuadrin e Dialogut Intensiv. Aleatët nënvizuan vendosmërinë e tyre për të thelluar më tej partneritetin NATO-Rusi dhe për të shfrytëzuar potencialin e plotë të Këshillit NATO-Rusi. Ata gjithashtu bënë thirrje për një bashkëpunim më të dendur dhe më të fuqishëm midis NATO-s dhe Bashkimit Europian. Sekretari i Përgjithshëm përmendi Afganistanin dhe Kosovën si “dy zona ku kjo është vërtetë shumë e rëndësishme”.

Në Lituani udhëheqësit e vendeve të NATO-s ripohuan lidhjen e domosdoshme midis Amerikës së Veriut dhe Europës dhe nënvizuan angazhimin për të vazhduar transformimin e Aleancës. Deklarata e Takimit përmbyllej: “Vendimet që ne kemi marrë së bashku, krahas me punën që kemi drejtuar, tregojnë se Aleanca po përshtatet me mjedisin e sigurisë së shekullit të 21-të përmes operacioneve të veta, aftësive të shndërruara të mbrojtjes dhe angazhimeve më të thella ndaj vendeve brenda dhe përtej Zonës Euro-Atlantike, si dhe përmes reformave të brendshme të vazhdueshme. Këto përpjekje do të përforcojnë misionin tonë në Afganistan dhe aftësinë e Aleancës për të përballuar sfida të tjera. Ne do të takohemi sërish në pranverë të vitit 2008, me qëllim që të vlerësohet përparimi dhe të jepen orientime të mëtejshme për transformimin e vazhdueshëm të NATO-s, duke përfshirë edhe procesin e zgjerimit”.

* Turqia e njëj Republikën e Maqedonisë me emrin e vet kushtetues.

NATO Public Diplomacy Division

1110 Brussels – Belgium

Website: www.nato.int

Email: natodoc@hq.nato.int

Division Diplomatique publique de l'OTAN

1110 Bruxelles – Belgique

Site web : www.otan.nato.int

Courriel : otandoc@hq.nato.int